



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 14 të Ligjit mbi tokën ndërtimore, G. z. e Kosovës nr.14/80 dhe 22/86, të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, par.1, pika b të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 04.05.2006, merr

V E N D I M
MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E ANTENËS, ME
PAJISJE TË NEVOJSHME PËRCJELLËSE, PËR NEVOJAT E “IPKO-NET”-it,
NË GËRMI

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e antenës, me pajisje të nevojshme përcjellëse, për nevojat e “IPKO-NET”-it, në Gërmi.

Neni 2

Lokacioni për vendosjen e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 224, në sipërfaqe prej 2.00 arë, të evidencuar në fletën poseduese nr. 153, zona kadastrale- Sofali, pronë komunale.

Neni 3

Lokacioni, nga neni 2 i këtij Vendimi, i jepet në shfrytëzim të përkohshëm “IPKO-NET”-it, në kohëzgjatje -10 vjet.

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të lokacionit, sipas këtij Vendimi, do të rregullohet me marrëveshje të veçantë mes Komunës dhe shfrytëzuesit të lokacionit

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e vendosjes së objektit investiv, për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësia e tyre e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.345-206, më 04.05.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri